REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 925/20
Datë/Datum. 12.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **Korporata Energjetike e Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **KEKO-20-008-2-2-1**

Sa i përket tenderit për *:* **Shërbimi i projektimit të rezervuarit të ri të mazutit 2000 m³**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

STUDIO HAPSIRA SHPK & TAULANT SHPK & AVE CONSULTING SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

MAT- PRISHTINË
(Adresa)
PRISHTINË *10000*
(Vendi)(Kodi postar)
045-150-123 /
(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

BESART HALIMI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
studiohapsira@gmail.com
(Adresa elektronike)

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR Studio Hapsira

12.11.2020
(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

N / A

(Emri i avokatit)

N /A

(Adresa e plotë)

N / A N / A

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

N / A

(Adresa elektronike)

N / A N / A

(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Më datën 20.01.2020 është publikuar njoftimi për kontratë.
- Afati i dorëzimit ofertave , data 14.02.2020 koha 13:00 E-PROKURIM
- Hapja e ofertave po të njëjtën datë : 14.02.2020 koha 13:00, E-PROKURIM
- Më datën 19.10.2020 jemi njoftuar me vendimin AK , si dhe letrat standarde
- lidhur me eleminimin tonë.
- Më datën 20.10.2020 kemi bërë kërkesë për Ri-shqyrtim të lëndës
- Me datën 03.11.2020 Na është refuzuar kërkesa për Ri-shqyrtim

Kriteri i dhënies Kontratës : Çmimi më i ultë i përgjegjëshëm.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Kemi dorëzuar ofertën në mënyrë elektronike

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Kërkesë për ri-shqyrtim kemi bërë me datën 20.10.2020 ,ndërsa autoriteti kontraktues me datën 03.11.2020 na ka refuzuar kërkesën për ri-shqyrtim me arsyetim :

KEK

Data 03.11.2020

PËR OPERATORIN EKONOMIK	STUDIO HAPSIRA SH.P.K
NGA	KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Zyra Ekzekutive e Prokurimit 10000 Prishtinë, rr. Nëna Terezë nr. 36 Emin Tmava, Drejtor i zyrës ekzekutive të Prokurimit
NUMRI I KËRKESËS PËR RISHQYRTIM	Nr. Protokollit
DATA E PARASHTRIMIT TË KËRKESËS	26.10.2020
SHQYTIMI I ANKESËS TË PARASHTRUAR	Kerkesa për rishqyrtim te vendimit
TITULLI I AKTIVITETIT TË PROKURIMIT	Shërbimi i projektimit të rezervuarit të ri të mazutit 2000 m3
Nr. I AKTIVITETIT TË PROKURIMIT	Nr. prokurimit në e prokurim: KEK-20-056-221 nr. brendshëm: KEKC-20-008-221
DATA E NJOFTIMIT PËR KONTRATË	21.01.2020
DATA E PRANIMIT TË TENDERËVE	14.02.2020

03 -11- 2020
Nr: 9835
PRISHTINË-A

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit në bazë të nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas kërkesës të parashtruar për rishqyrtim nga Operatori STUDIO HAPSIRA SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Shërbimi i projektimit të rezervuarit të ri të mazutit 2000 m3, Autoriteti Kontraktues mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e paraqitur për rishqyrtim nga Operatori Ekonomik STUDIO HAPSIRA SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Shërbimi i projektimit të rezervuarit të ri të mazutit 2000 m3, me nr. prokurimit KEKC 20 008 221.

ARSYETIM

Me datën: 19.10.2020 KEK-u ka pranuar kërkesën për rishqyrtim e parashtruar nga OE STUDIO HAPSIRA SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Shërbimi i projektimit të rezervuarit të ri të mazutit 2000 m3, me nr. prokurimit KEKC 20 008 221, pas ekzaminimit të Dosjes së tenderit dhe shqyrtimit të rrjedhjes së procedurës së tenderimit, komisioni profesional ri vlerësues i Autoritetit Kontraktues në bazë të kërkesës për rishqyrtim te OE sqaron me sa vijon:

ANALIZA DHE SQARIMI I KOMISIONIT TE VLERESIMIT

Komisioni i ri vlersimit ka shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim te OE ne pikat ankimore qe ka bere ndaj ofertës se grupit te OE "I.E.C-BIO L.L.C" & N.N.SH "EGO-ELSA & "ASTREKS DOOEL" i cili grup nga komisioni i rivlerësimit është rekomanduar për dhënie te kontratës për keté tender. OE ankues ka bere 4 pretendimi ankimore, lidhur ketë vendim, dhe nga komisioni i ri vlerësimit për te gjitha këto pika ankimore ka konstatuar qe janë te pabazuar, për këto arsye:

PRETENDIMI ANKIMOR NR.1. nga OE STUDIO HAPESIRA SHPK .
Grupi i OE "I.E.C-BIO L.L.C" & N.N.SH "EGO-ELSA & "ASTREKS DOOEL" për lider te kësaj kontrate ka autorizuar OE "I.E.C-BIO L.L.C" & N.N.SH për implementim te kësaj kontrate ku drejtor është Faton Gashi, i cili ka edhe deklaratën nen betim. Po ashtu edhe anëritë tjerët e grupit i plotësojnë te gjitha kërkesat e FDT-se. Prandaj komision i ri vlersimit për ketë pike ankimore nga STUDIO HAPESIRA SHPK, konstaton qe është i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR NR.2. nga OE STUDIO HAPESIRA SHPK .
Pretendimi i OE STUDIO HAPESIRA SHPK qe kompania Astreks nuk ka referenca për projekte te ngjashme ne tri vitet e fundit është i pabazuar. Kjo kompani ka referenca për pune te ngjashme shih ofertën e OE te shpallur fitues. Komisioni i rivlerësimit konstaton qe ky pretendim ankimor është i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR NR.3 nga OE STUDIO HAPESIRA SHPK .
Ky pretendim i OE STUDIO HAPESIRA SHPK është i pabazuar sipas komisionit te rivlerësimit për arsye se Faton Gashi nuk është menaxher i projektit, sepse sipas dokumenteve dhe marrëveshjes se konzorciumit ai është lideri i konzorciumit te grupit OE qe është i autorizuar edhe për kontaktim te kontratës. Kurse projekt menaxher për projektim te rezervuarit 2000 m ³ është i caktuar inxhinierja me përvoje profesionale mbi 27 vjeçare Metodija Tomeski. Si dhe grupi i inxhinierëve te profileve te ndryshme qe janë kërkuar për ketë projekt (6 inxhinier te diplomuar). I gjithë ekipi i inxhinierëve qe merr pjese ne ketë projekt janë inxhinier te diplomuar ne ish sistemin (5 vjeçar te studimeve) dhe kanë autorizime për projekte industriale. Andaj komisioni konstaton që kjo pike ankimore është e pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR NR.4 nga OE STUDIO HAPESIRA SHPK .
Pretendimi ankimor nr.4 është i pabazuar. Ky pretendim ankimor nuk qëndron dhe është i pabazuar sepse te gjithë inxhinierët e përfshirë ne liste te grupit te OE te shpallur fitues janë Inxhinier te diplomuar dhe me përvoje te gjate profesionale plus kanë autorizimin nga shteti qe mund te merren me projektime sipas profileve, po ashtu edhe CV qe kanë dhënë inxhinierët qe janë ne liste ne krye me Menagjerin e projektit qe është caktuar Metodija Tomeski, për komisionin kanë qene te kuptueshme edhe pse disa kanë qene ne gjuhen maqedonase .

Komisioni i rivlerësimit edhe pas rishqyrtimit te pikave ankimore nga OE STUDIO HAPESIRA SHPK mbetet ne qëndrime dhe vlerësimet e veta te dhëna ne raportin e rivlerësimit. Te gjitha pikat ankimore nga OE STUDIO HAPESIRA SHPK për komisionin janë te pabazuar.

REKOMANDIMI I KOMISIONIT TE VLERESIMIT TE AUTORITETIT KONTRAKTUES

Komisioni i rivlerësimit i rekomandon zyrtarit përgjegjës te prokurimit që kërkesa për rishqyrtim e OE STUDIO HAPESIRA SH.P.K, për tenderin e larte cekur te refuzohet si e pabazuar.

KONKLUZIONI I ZYRTARIT PËRGJEGJËS TE PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar në kërkesën për rishqyrtim te OE STUDIO HAPESIRA shpk i cili është i pakënaqur me vendimin e autoritetit kontraktues si dhe analizën, sqarimet dhe rekomandimet e komisionit te rivlerësimit për aktivitetin e prokurimit te lart cekur e refuzon si te **PABAZUAR** ankesën/ kërkesën për rishqyrtim te OE.

Këshilla Juridike:
Kundër këtij vendimi, Operatori Ekonomik mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së konform dispozitave ligjore te LPP-se.

Vendimi t'i dorëzohet :
1x1 ekzemplar – Operatorit Ekonomik;
1x1 ekzemplar – Për dosjen e aktivitetit të Prokurimit;
1x1 ekzemplar – Arkivës së KEK-ut;

Me.d. Drejtori i Zyrës Ekzekutive të Prokurimit
Flamur Bekteshi
03.11.2020

NE NUK PAJTOHEMI ME VENDIMIN E DATËS 03.11.2020 TË KOMISIONIT VLERËSIMIT PASI ËSHTË NË KUNDËRSHTIM ME GJENDJEN FAKTIKE

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

NENI 13 : Përdorimi i Gjuhëve zyrtare, paragrafi 4
NENI 56 : Dizpozita e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave .
NENI 59 : Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.
NENI 69 : Aftësia teknike dhe /ose profesionale
NENI 71 : Formi grupit Operatorëve Ekonomik
RRUOPP (Rregullat dhe Udhëzuesi Operativë i Prokurimit Publikë)

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pas çasje së dokumenetve zyrtare me datën 20.10.2020 në ora 9.31 , kemi analizuar dhe krahasuar dokumentet e tenderimit për GOE e rekomanduar për kontratë dhe kemi konstatuar , se GOE I rekomanduar për kontratë nuk I plotëson kërkesat e përshtatshmërisë profesionale dhe teknike NENI 9.1 dhe 9.2 i FDT-së dhe njoftimit për kontratë , andaj duhet të shpallet e pa përgjegjëshme bazuar në provat dhe pretendimet në vijim :

PRETENDIMI ANKIMORË 1 AK-së:

Antari të Grupi OE të deklaruar ASTREX- i mungon Çertifikata TVSH dhe Numri Fiskal
Antari të Grupi OE të deklaruar NNSH EGOELSA- i mungon Çertifikata TVSH

Konform NENI 7.1&7.2 të kërkesat e përshtatshmërisë profesionale :

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	**Profesionalna podobnost** **1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;** **2.Regjistrimi i TVSH; ne vendin e themelimit** **3.Regjistrimi i numrit fiskal**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1.Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend Kopja e certifikatës së biznesit, me përshkrim te veprimtarisë për projektime të objekteve industriale;** **2.Kopja e certifikatës TVSH-se;** **3.Kopja e certifikatës numrit fiskal**

Kusht Administrativë FDT-së : Operatorët ekonomik që konkurojnë në këtë aktivitet prokurimit duhet të jenë deklarues të TVSH-së , të dëshmojë me kopje përkatëse të certificates së TVSH-së

AUTORITETI KONTRAKTUES I KA IKUR KËTIJ PRETENDIMI ANKIMORË DUKE ANASHKALUAR DHE MOS U PËRGJIGJUR NË KËTË PRETENDIM (Provë-Shiqo Vendimin e datës 03.11.2020 të Autoriteti Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim)

PRETENDIMI ANKIMORË 2 AK-së:

Referencat e GOE Astrex – Referenca OLTI –Sllovenia , nuk është reference sipas natyrës sipas fushëveprimit të ngjashme të kontratës , pasi në reference nuk dëshmohet se kompania Astrex e deklaruar si anatarë GEO në këtë tender ka projektuar një rezervuar mazutit apo të ngjashëm sipas kërkesës së AK-së t.

9.1 & 9.2	**Tehničke i profesionalne mogućnosti** **1.Projekte të ngjashëm të realizuar ne tre vitet e fundit.** **2. Kualifikim et shkollore dhe profesionale te personelit.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. O.E. duhet te prezantoje se paku 2 (dy) referencë apo certifikate mbi përfundimin e shërbimeve nga punëdhënësi mbi implementimin e suksesshëm te projekteve të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit per kontrat, me kontaktet për verifikim, me një fushëveprim te ngjashëm te shërbimeve, nga ku mund të shihet kapaciteti teknik dhe përvoja e tij.** **2 Lista e personelit teknik qe do te angazhohet ne realizimin e projektit.**

Kjo refrencë nuk përmbushë kërkesa të fushëveprimit të ngjashëm sipas kërkesa mbi mundësin teknike dhe profesionale, pasi në refrencë nuk precizohet apo specifikohet që kompania Astrex ka projektuar rezervuar mazuti apo depo për ruajtjen e hidrokarbureve.

Në reference precizohet që kompania Astex ka projektuar Objekte Arkitektonike dhe infrastukturore me sipërfaqe 40000m2

PRETENDIMI ANKIMORË 3 AK-së:

Caktimi I menaxherit projektit

Bazuar në kërkesa mbi mundësin teknike dhe profesionale mbi caktimin e menaxherit kontratës :

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Tehničke i profesionalne mogućnosti** **1.Projekte të ngjashëm të realizuar ne tre vitet e fundit.** **2. Kualifikim et shkollore dhe profesionale te personelit.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. O.E. duhet te prezantoje se paku 2 (dy) referencë apo certifikate mbi përfundimin e shërbimeve nga punëdhënësi mbi implementimin e suksesshëm te projekteve të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit per kontrat, me kontaktet për verifikim, me një fushëveprim te ngjashëm te shërbimeve, nga ku mund të shihet kapaciteti teknik dhe përvoja e tij.** **2 Lista e personelit teknik qe do te angazhohet ne realizimin e projektit.** **• Operatori ekonomik duhet te përcaktoj Menaxherin e Projektit, me përgatitje profesionale master apo inxhinier i diplomuar i makinerise, ndërtimtarisë ose teknologjisë, të ketë përvoje për projektime të objekteve industriale min 2 vite ne projektime te objekteve industriale dhe të ketë qenë se paku 1 (një) herë projektant kryesor për projektimin e rezervuarëve mbitokësor të mazutit në vëllim jo më të vogël se 1000m3, këtë duhet ta dëshmoj me CV dhe kopje te diplomës.**

Grupi I Operatorëve NNSH EGO ELSA & I.E.C-BIO L.L.C&ASTREX DOOEL , me vendim mbi caktimin e menaxherit projektit , kane deklaruar Faton Gashi si menaxher të këtij projektit.

Sipas kërkesë së AK Menxhari I Projektit duhet të jetë me pregaditje profesionale Master apo Inxhinier I diplomuar I makinerisë , ndërtimtarisë apo teknologjisë , dhe të ketë përvojë për projektime të Objekteve Industriale minimum 2 vite , dhe të jetë projektantë të rezervuarëve mbitoksorë minimum një rezervuar me kapacitet jo më të vogës se 1000m3.

Z. Faton Gashi I caktuar me vendin nga GOE , nuk figuron në listën e inxhinierve , nuk ka ofruar dëshmi (I mungon Diploma) lidhur me kualifikimin profesional njëra nga fushat sipas kërkesës së AK-së , mungon CV, dhe nuk ka dëshmi apo reference pune nese ka projektuar një rezervuar mazuatit jo më të vogël se 1000 m3.

Konform NENI 71 të LPP-së Caktimi I menaxherit në kuadër Grupit Operatorve , bëhet me vendim e jo me listë, me vendim është caktuar si menaxheri I projektit z. Faton Gashi.

Në kuadër të listë së inxhinierve të prezentuar nga GOE I.E.C-BIO L.L.C ka prezentuar një projekt menaxher i cili është kundërshtim me vendimin e Grupit Operatorve Ekonomik që marrim pjesë në këtë tender.

Provë Materiale :

Number of procurement: KEK-20-56-2-2-1

Title of contract:" Shërbimi i projektimit të rezervuarit të ri të mazutit 2000 m³

STATEMENT FOR CONTRACTING AUTHORIZATION

Me as the representative of " ASTREX DOOEL" (Marko Jasmak), verify to this that the "I.E.C-BIO L.L.C" is authorized as partner to sign all relevant documents of this project and declare that the manager of this project which is appointed by the consortium is the person Faton Gashi also representative of our enterprise.

In case of any eventual change during the project implementation of this agreement, we will inform immediately in writing form the investiture .

Details of cooperation between the company " ASTREX DOOEL"&"I.E.C-BIO L.L.C" are defined more clearly in the internally pre-contract between them.

" ASTREX DOOEL"

"I.E.C-BIO L.L.C"

L.L.C. I.E.C-BIO PRISHTINE

Në deklaratë shifet qartë që GOE me deklaraten e konzorciumit kanë autorizuar dhe caktuar Faton Gashin si projekt Menaxher I Projektit

Në Gjuhën Angleze :

Me as the ASTREX DOOEL (Marko Jasmak), verify of this that the I.E.C-BIO L.L.C is authorized as a partner to sign all relevant documents of this project and declare the menager of this project which is appointed by the consorcium is the **Faton Gashi** also representative of the eneterprise

Përkthim në gjuhën shqipe :

Unë si ASTREX DOOEL (Marko Jasmak), vërtetoj për këtë që IEC-BIO LLC është i autorizuar si partner për të nënshkruar të gjitha dokumentet përkatëse të këtij projekti dhe për të deklaruar se menaxheri i këtij projekti i caktuar nga konsorciumi është edhe Faton Gashi përfaqësues i ndërmarrjes

Përgjigjen e Autoritetit Kontraktues "KEK SH.A" lidhur me këtë pretendim :

PRETENDIMI ANKIMOR NR.3 nga OE STUDIO HAPESIRA SHPK .

Ky pretendim i OE STUDIO HAPESIRA SHPK është i pabazuar sipas komisionit te rivlerësimit për arsye se Faton Gashi nuk është menaxher i projektit, sepse sipas dokumenteve dhe marrëveshjes se konzorciumit ai është lideri i konzorciumit te grupit OE qe është i autorizuar edhe për kontaktim te kontratës. Kurse projekt menaxher për projektim te rezervuarit 2000 m ³ është i caktuar inxhinierja me përvoje profesionale mbi 27 vjeçare Metodija Tomeski. Si dhe grupi i inxhinierëve te profileve te ndryshme qe janë kërkuar për ketë projekt (6 inxhinier te diplomuar). I gjithë ekipi i inxhinierëve qe merr pjese ne ketë projekt janë inxhinier te diplomuar ne ish sistemin (5 vjeçar te studimeve) dhe kanë autorizime për projekte industriale. Andaj komisioni konstaton që kjo pike ankimore është e pabazuar.

Shihet qartë që është kundërthënës me përgjigjne AK (Komisioni Vlerësimi ose nuk e ka kuptu anglishten ose ka bërë përgjigje selektive duke ja përshtatur preferencave të veta.

Bazuar në Dokumentin e prezentuar nga Grupi I Operatorëve Ekonomik " DEKLARATËN PËR AUTHORIZIMIN E KONTRAKTIMI "- Kanë deklaruar dhe caktuar si menaxher projektit Faton Gashi si përfaqësues ndërmarrjes , I cili nuk I plotëse kërkesa mbi mundësia profesionale dhe teknike të AK të precizuar në FDT dhe në njoftim për kontratë.

Deklarat mbi autorizimin është bërë në Kundërtim me NENI 71 Të LPP (Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik) paragrafi 3, pasi në këtë rast mungon në Deklaratë mungon vula dhe nënëshkrimi i kompanisë I.E.C-BIO L.L.C-Kërkesave e pershtatshmërisë Profesionale dhe teknike të vendosura nga AK duhet të plotësohen në tërësi nga Grupi I Operatorëve që Konkurojnë në këtë tender e jo individuale-

ME KËTË RAST NJËRI PREJ GRUPIT OPERATORËVE NUK E KA NËNSHKRUAR DEKLARATEN E AUTORIZIMIT MBI KONTRAKTIMI, SI DHE CAKTIMIN E MENAGJERIT PROJEKTIT

Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik

1. Të gjithë anëtarët e grupit në fjalë janë së bashku dhe secili veçmas të përgjegjshëm para autoritetit kontraktues për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i epet grupit në fjalë, ata gjithashtu janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës në fjalë. Të gjitha autoritetet kontraktuese në dosjet e tyre të tenderit duhet ta përfshijnë një njoftim lidhur me këtë çështje.

4. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit

NUK KA VENDIM NGA GRUPI I OPERATORËVE EKONOMIK MBI CAKTIMI E MENAXHERIT KONTRATËS znj METODIJA TOMESKI- Menaxheri I projektit

caktohet me vendim , pra përgjigja e Autoriteti Kontraktues me rastin e refuzimin të kërkesë për rishqyrtim në pretendimin ankimor 3 – ËSHTË KUNDËRTHËNËSE

Lidhur me këtë pretendim , kërkesa e AK nuk është përmbushuar dhe Konform NENIT 69 të LPP-së tenderi refuzohet pa kërkuar informacione shtesë

PRETENDIMI ANKIMORË 4 AK-së:

Inxhinierët e përfshirë në listë :

1. **Metodija Tomeski - Në vend të diplomës ka afruar çertifikat ,nëse ju referohemi përkthimin gjyqësorë titullin Bachelor e jo inxhininier I diplomuar sipas kërkesë së FDT-së**
2. **Stamat Samduloski - Në vend të diplomës ka afruar çertifikat ,nëse ju referohemi përkthimin gjyqësorë titullin Bachelor e jo inxhininier I diplomuar sipas kërkesë së FDT-së.**
   CV- Ka dorëzuar në gjuhën maqedone –në kundërtshtim me NENI 13 të LPP-së përdori I gjuhëve zyrtare , pasi gjuha maqedone nuk është gjuhë zyrtare
3. **Stojan Petrovski - Në vend të diplomës ka afruar çertifikat ,nëse ju referohemi përkthimin gjyqësorë titullin Bachelor e jo inxhininier I diplomuar sipas kërkesë së FDT-së.**
   CV- Ka dorëzuar në gjuhën maqedone –në kundërtshtim me NENI 13 të LPP-së përdori I gjuhëve zyrtare , pasi gjuha maqedone nuk është gjuhë zyrtare .
4. **Stojan Petrovski - Në vend të diplomës ka afruar çertifikat ,nëse ju referohemi përkthimin gjyqësorë titullin Bachelor e jo inxhininier I diplomuar sipas kërkesë së FDT-së.**
   CV- Ka dorëzuar në gjuhën maqedone –në kundërtshtim me NENI 13 të LPP-së përdori I gjuhëve zyrtare , pasi gjuha maqedone nuk është gjuhë zyrtare .

5. **Zvonimir Todoroski - Në vend të diplomës ka afruar çertifikat ,nëse ju referohemi përkthimin gjyqësorë titullin Bachelor e jo inxhininier I diplomuar sipas kërkesë së FDT-së.**

   I MUNGON CV-ja

6. **Lazo Jankullovski - Në vend të diplomës ka afruar çertifikat ,nëse ju referohemi përkthimin gjyqësorë titullin Bachelor e jo inxhininier I diplomuar sipas kërkesë së FDT-së.**

CV- Ka dorëzuar në gjuhën maqedone –në kundërtshtim me NENI 13 të LPP-së përdori I gjuhëve zyrtare , pasi gjuha maqedone nuk është gjuhë zyrtare .

7. **Vladoja Samak- Në vend të diplomës ka afruar çertifikat ,nëse ju referohemi përkthimin gjyqësorë titullin Bachelor e jo inxhininier I diplomuar sipas kërkesë së FDT-së.**

CV- Ka dorëzuar në gjuhën maqedone –në kundërtshtim me NENI 13 të LPP-së përdori I gjuhëve zyrtare , pasi gjuha maqedone nuk është gjuhë zyrtare .

Komisioni gjatë vlerësimi të ofertës ka vepruar në kundërshtim me NENI 13 të LPP-së , pasi GOE I propozuar për dhënie kontratës , 90% të stafit ka ofruar CV në gjuhën maqedone, e jo në gjuhë zyrtare ashtu siq e precizon NENI 13 , paragrafi paragrafi 4

Neni 13
Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik

1. Autoriteti kontraktues do ti përgatisë të gjitha dosjet e tenderëve, njoftimet, ftesat dhe dokumentet e tjera që janë publikuar ose u janë dhënë operatorëve ekonomik gjatë ushtrimit të një aktiviteti të prokurimit që shpien drejt dhënies së një kontrate ose konkursi të projektimit me vlerë minimale, të vogël dhe të mesme në gjuhën Shqipe dhe Serbe. Autoriteti kontraktues mundet që gjithashtu t'i përgatisë dokumentet në fjalë edhe në gjuhën Angleze.

4. Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze.

Me këtë rast Autoriteti Kontraktues i ka ikur një kriter të tillë në kundërshtim me NENIN 13 të LPP-së, Grupi i operatorëve i rekomanduar për kontratë duhet të shpallet i pa përgjegjëshëm.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka zbatues interpretimin e KRPP " Te pyetje e Shpeshta NR 66" ku shumë qartë e precizon për dokumentet bazike per vlerësim duhet ta kenë përkthimin e qartë dhe të kuptueshëm për komisionin e vlerësimit po ashtu edhe OE ekonomik konkurent që marrin pjesë në aë tënder , gjatë qasje së dokumenetev zyrtare të kuptojnë dhe të konstatojnë në Komisioni Vlerësues ka vepruar konfor ligjit LPP.

ME KË RAST CV JANË DOKUMENTE BAZIKE PËR VLERËSIMIN E TENDERIT JANË NË GJUHËN MAQEDONE DHE TË PA KUPTUSHME PËR NE SI OPERATOR PËR TË VLERËSUAR NËSE ATO CV PËRMBUSHIN KËRKESAT E FDT DHE TË NJOFTIMIT PËR KONTRATË.

ME KËTË RAST AK I KA IKUR NJË KRITERI TË TILL

- Ne STUDIO HAPSIRA SHPK – Deklarojmë se kemi plotësuar , dërguar dhe dorëzuar të gjitha kërkesat dhe dëshmitë e dokumentuara të parashtrauara nga ana e AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit në harmoni me LPP ,

- Ne STUDIO HAPSIRA SHPK- *Kemi ofertuar me çmimin konkurues dhe kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi me çmimin me të ultë.*
  Të gjitha Autoritet Kontraktues , janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë ekonomike , njëkosisht duke marrë në konsiderat lëndën dhe qellimin e prokurimit.

- Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatatë e kërkuara janë vendosur dhe përshkruar në këtë NEN, duhet të jenë drejtëpërdrejtë relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

- Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit , të gjitha Autoritet Kontraktuese do të sigurojnë *(i) pjesëmarrjen me të gjërë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimi i rregullt, dërgimi dhe /ose disponueshmëria e gjitha njoftimeve, ftesave , informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj ;* ***(iii) eleminimin e praktikave, kritereve , kërkesave dhe specifikimeve teknikeqë***

diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik ; *(iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie , duke përfshire rëndësin relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë; (v)* ***që asnjë kërkesë , specifikim që nuk është saktësuar kështu të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënie*** *; (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektët përmbajtësore të kushteve ,kritereve dhe specifikimeve teknike.*

PËRFUNDIM :

Duke u bazuar në argumentet e specifikauar më lartë kërkojmë nga AK të bëjë anulimin E vendimit për dhënie të tenderit , e njëjta ta kthejë lëndën në rivlerësim dhe të marrë si të bazuar Ankesën tonë ,pasi konsiderojmë që AK gjatë këtij aktiviteti të prokurimit në masë substanciale nuk e ka rrespektuar LPP

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e supozuara kanë shkaktuar dëmtim të imazhit kompanisë , një numër i konsiderushëm të punëtorve kanë mbetur pa punë , duke llogaritet shpenzimet , kamatatë , tarifën e avokatit deri sa të zgjidhen **kontekstet.**

Vlera e dëmit kap vlerën 20, 000.00€, **të cilën Autoriteti Kontraktues është i obliguar të ja paguaj palës dëmtuar në rast se humb kontekstin Gjyqësorë**

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*